



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR “PËR AUDITIMIN E ZBATIMIT TË  
REKOMANDIMEVE, NË AUDITIMET E EVADUARA GJATË 6-MUJORIT TË  
PARË TË VITIT 2023”.**

**RAPORT I KONSOLIDUAR I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË  
AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA GJATË 6-MUJORIT TË PARË TË  
VITIT 2023**

*DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QENDRORE*

**Tiranë, Dhjetor 2023**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqja</b>
<b>1</b>	<b>Përmbledhje ekzekutive</b>	<b>3-4</b>
1.1	Hyrje	4-4
1.2	Objektivat	4-5
1.3	Qëllimi	5-5
1.4	Metodologjia	5-5
1.5	Konkluzione	5-5
<b>2</b>	<b>Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve</b>	<b>5-5</b>
<b>3</b>	<b>Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 2022</b>	<b>5-64</b>
3.1	Gjykata e Lartë	5-9
3.2	Autoriteti i Mediave Audiovizive	9-21
3.3	Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit	21-27
3.4	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët	27-33
3.5	Agjencia Kombëtare e Rinisë	33-38
3.6	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	38-48
3.7	Shërbimi i Trupit Diplomatik	48-61
<b>4</b>	<b>Anekse</b>	<b>62-64</b>
4.1	Rekomandimet për përmirësime/ndryshime legjislacioni / Masa organizative	62-62
4.2	Masa shpërblim dëmi	62-62
4.3	Masa për eliminimin e efekteve negative (3E)	62-62
4.4	Masa disiplinore / Masa administrative	62-63
4.5	Shkalla e pranueshmërisë dhe zbatimit të rekomandimeve sipas llojit të masës për secilin subjekt të audituar	63-64
<b>5</b>	<b>Dokumente shoqërues</b>	<b>64-64</b>

## I. PËRMBLEDHJE

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2023, sipas programit të auditimit nr. 900/1, datë 11.10.2023, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023”, si dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr. 1, datë 04.11.2016 “*Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në institucionet:

1. Gjykata e Lartë
2. Autoriteti i Mediave Audiovizive
3. Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
4. Ministër Shteti për Rininë dhe Fëmijët
5. Agjencia Kombëtare e Rinisë
6. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
7. Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik

ka rezultuar si në vijim:

Konstatohet se nga 7 auditimet e kryera:

- **7 subjektet** (*Gjykata e Lartë, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Agjencia Kombëtare e Rinisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik*), kanë respektuar afatin prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 shkronja “j” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Konstatohet se nga 7 auditimet e kryera:

- **1 subjekt** (*Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit*) ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 muajor në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- **3 subjekte** (*Gjykata e Lartë, Ministër Shteti për Rininë dhe Fëmijët, Agjencia Kombëtare e Rinisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit*) nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 muajor në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- **3 subjekte** (*Autoriteti i Mediave Audiovizive, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Drejtoria e Shërbimit të trupit Diplomatik*) janë brenda afatit 6 muajor të kthimit të përgjigjes në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Niveli i realizimit të masave sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë:

**Masa për përmirësim/ndryshime legjislativ:** Nga 4 masa të rekomanduara janë pranuar plotësisht të 4 rekomandimet ose në masën 100%. Nga **4 masat** e pranuar 3 rekomandime ose 75 % janë zbatuar plotësisht dhe 1 rekomandim ose 30 % është në proces zbatimi.

**Masa organizative:** Nga 113 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 113 rekomandime ose ne masën 100%. Nga **113 masat** e pranuar janë zbatuar plotësisht 72 rekomandime ose 63.71 % janë zbatuar, 34 rekomandime ose 30.08 % si dhe rezultojnë të pa zbatuara dhe 7 rekomandime ose 6.19 % rezultojnë pa zbatuar.

**Masa për eliminimin e efekteve negative** në administrimin e fondeve publike janë rekomanduar gjithsej **18 masa**, në shumën **195,817 mijë lekë** të pranuar 100% nga subjektet , nga të cilat janë zbatuar plotësisht **8 masa në vlerën 438 mijë lekë** dhe janë në proces zbatimi **10 masa në vlerën 195.378 mijë lekë**.

**-Masa shpërblim dëmi:** Nga 7 masa të rekomanduara në vlerën 19,783 mijë lekë, janë pranuar plotësisht 7 rekomandime ose 100 % e tyre në vlerën 19,783 mijë lekë . Nga 7 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 3 rekomandime ose 42.86 % me vlerën 438 mijë lekë; janë në proces zbatimi 2 rekomandime ose 28.57 % me vlerën 971 mijë lekë si dhe rezultojnë të pa zbatuara 2 rekomandime ose 28.57 % me vlerën 18,374 mijë lekë.

**-Masa disiplinore:** Nga 22 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 22 rekomandime ose 100 % . Nga 22 masat e pranuar 1 rekomandime ose 4.55 % u zbatua plotësisht, 20 rekomandime ose 90.91 % e tyre është në proces zbatimi dhe 1 rekomandim ose 4.55 % e tyre rezultoi i pa zbatuar.

**-Masa administrative:** Rekomanduar 1 masë administrative, e cila rezultoi e pranuar plotësisht ose 100 %. Nga 1 rekomandim i pranuar, rezultoi 1 rekomandime plotësisht i zbatuar ose 100 %.

## 1.1 HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 900/1 datë 11.10.2023 nga data 11.10.2023 deri në datën 25.10.2023, KLSH kreu auditimin e përputhshmërisë “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”

Auditimi u krye nga:

1. E. K., Përgjegjës Grupi
2. E. K.
3. A. K.
4. A. M.

Auditimi filloi më datë 11.10.2023

Auditimi përfundoi më datë 25.10.2023

## 1.2 Objektivat

Hartimi i programit (Planit të veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjisllacionin në fuqi.
3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ.
4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik.
5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe economicitet.
6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative.

7. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

### 1.3 Qëllimi

Vlerësimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna, nga auditimet e mëparshme, koherencës së tyre dhe përgjegjshmërisë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

### 1.4 Metodologjia

Duke pasur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit dhe dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, u auditua niveli i zbatimit të secilit rekomandim në subjektet e përzgjedhura, vlerësuar sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së kryerjes së auditimit në terren.

### 1.5 Konkluzione

Për çështjet e shqyrtuara janë zhvilluar ballafaqime gjatë fazës së auditimit në terren dhe në përfundim të tij janë mbajtur akt verifikime për çdo subjekt të audituar, mbi rezultat e të cilit është përgatitur ky Raport Auditimi.

## 2. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2023, sipas programit të auditimit nr. 900/1, datë 11.10.2023, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023”, si dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr. 1, datë 04.11.2016 “*Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, rezultoi se në **7 auditime në subjekte**, janë rekomanduar gjithsej **166 rekomandime**, nga të cilat janë pranuar **166** ose në masën 100%.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezultoi se nga **166** masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht **88** prej tyre ose **53,01%**, zbatuar pjesërisht **2** masa ose **1,20 %** e totalit të masave të pranuar, në proces zbatimi **66** masa ose **39,76%**, dhe pa zbatuar rezultuan **10** masa, ose **6,02 %**.

## 3. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA PËR PERIUDHËN 6-MUJORI I PARË I VITIT 2023

Të analizuar dhe të detajuara sipas çdo subjekti dhe sipas llojit të masave të rekomanduara, niveli i zbatimit të tyre paraqitet si vijon:

### 3.1 GJYKATA E LARTË

#### PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 900/1 prot., datë 11.10.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, në ambientet e institucionit, më datë 25.10.2023, u mbajt aktverifikimi nr.1, datë 25.10.2023 nga audituesit e autorizuar të KLSH-së E. K. (p/grupi), znj. E. K. anëtare, me znj. A.K. në cilësinë e Kancelarit të institucionit dhe znj. F. A. në cilësinë e Drejtorit Ekonomik të autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së.

**Objekt i këtij akt verifikimi është:**

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.554/8 Prot, datë 21.02.2023–për Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Mbi Auditimin e Përputhshmërisë*” të ushtruar në **Gjykatën e Lartë**, sipas programit të auditimit nr. 554/3 prot., datë 10.10.2022, për veprimtarinë nga data 01.01.2020 deri në datën 30.09.2022, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. E. K. (Përgjegjësi i Grupit)

2. E. K., anëtar

Auditimi ka filluar më, 11.10.2023

Auditimi ka përfunduar më, 25.10.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.900/1 prot., datë 11.10.2023 me objekt: “*Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH për auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023*”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrimit elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

## **TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT**

Nga auditimi i ushtruar në **Gjykatën e Lartë** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” për periudhën nga data 01.01.2020 deri në datën 30.09.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 41, datë 20.03.2023, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 554/8, datë 21.02.2023, rezulton se:

**I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.**

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka dërguar planin e veprimit me shkresën me nr.5176/10 prot., datë 14.3.2023 me lëndë “Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike –financiare” nga KLSH”, brenda afatit ligjor 20 ditë, të përcaktuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezulton se ka zbatuar afatin 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.**

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, Gjykata e Lartë *nuk* ka raportuar ne shkrim pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në

kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.

Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

### **III. Realizimi i rekomandimeve**

Nga ana e KLSH-së, janë lënë **8** Masa Organizative, nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **8** Masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht **dhe** kanë statusin e ecurisë së zbatimit **8 masa** organizative janë **zbatuar plotësisht**.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në Kuvendin e Shqipërisë paraqitet si vijon:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1.1.Rekomandimi:** Në vijimësi të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 22.11.2022, botuar në Fletoren Zyrtare me datë 09.01.2023, Gjykata e Lartë në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësorë të marrin masa për hartimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore mbi trajtimin financiar, sa më të drejtë dhe në masë sa më të përafërt të anëtareve të GJL, pavarësisht se nga cila gjykatë apo karrierë profesionale vijnë, me qëllim rekrutimin e gjyqtarëve më të mirë të vendit, në terma kohorë afatgjatë, duke garantuar ruajtjen e pavarësisë dhe misionit që ka Gjykata e Lartë, si gjykatë karriere.

#### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**2.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masat në vijimësi për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim sa më të drejtë të pasqyrave financiare, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

#### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**3.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masat për sistemimin e këtyre vlerave, të cilat janë të parashkruara dhe të paarkëtueshëm, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

#### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**4.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi, që pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë të titullit ekzekutiv, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

#### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

**5.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa për sistemimin kontabël të llogarisë 212

“Ndërtim e konstruksione”, duke e debituar këtë llogari me shumën prej 399,000 lekë.

#### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**6.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi, që pas miratimit të nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësorë të bëjë veprimet kontabël, duke kredituar llogarinë e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimi dhe debituar përkatësisht llogarinë 219 “Amortizimi i akumuluar i aktiveve afatgjata” dhe llogarinë 24 “Aktive te Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”.

#### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**7.1 Rekomandimi:** Gjykata e Lartë të marrë masat në vijimësi, që në çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël, të realizojë inventarizimin e dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik fitues, sipas kritereve të përcaktuara në ftesën për ofertë, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit.

#### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**8.1 Rekomandimi:** Nga Gjykata e Lartë të ribëhet kërkesë pranë Departamentit të Administratës Publike në lidhje me kategorizimin e trajtimit për “*shtesë page për natyrë të veçantë pune*” për specialistët e IT-së, shoqëruar me një analizë të hollësishme në lidhje me përmbajtjen e sistemit dhe klasifikimin e tij si “*Baza e të dhënave shtetërore*”.

#### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti **i zbatuar**

### **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Gjykatën e Lartë për në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 41, datë 20.03.2023, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 554/8, datë 21.02.2023, për veprimtarinë nga data 01.01.2020 deri më datë 30.09.2022, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, nuk ka respektuar afatin për njoftimin brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “*Ecuria e zbatimit të rekomandimeve*”

Subjekti dhe lloji i masës	Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar			
		Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
Gjykata e Lartë	8	8	-	8	-	-	-
Masa Organizative	8	8	-	8	-	-	-



Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 8 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht ose 100 %, dhe rezultojnë të zbatuara plotësisht 8 masa (100 %).

### **3.2 AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

#### **PËRMBLEDHJE**

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.900/1 prot, datë 11.10.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, në ambientet e institucionit, më datë 25.10.2023, u mbajt aktverifikimi nr.2 datë 25.10.2023 nga audituesit e autorizuar të KLSH-së znj. A. H. (K.) (përgjegjëse grupi) dhe znj. A. M. anëtar, me përfaqësues nga ana e AMA znj. A. K. në cilësinë e Kryetarit të Institucionit, z. Q.L. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve, znj. D.D. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Ligjore dhe personat e autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së

#### **Objekt i këtij akt verifikimi është:**

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.896/9 datë 18.05.2023 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” të ushtruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive sipas programit të auditimit nr.896/2 prot, datë 03.11.2022 i ndryshuar për veprimtarinë nga data 01.01.2019 deri më datën 30.06.2022, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe nivelin e zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

A. K. (H.) (Përgjegjësi i Grupit)

A. M., anëtar

Auditimi ka filluar më, 16.10.2023

Auditimi ka përfunduar më, 25.10.2023

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “*Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacionin që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH*”.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 900/1, datë 10.2023 me objekt: “*Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve*”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronike institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

#### **TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT**

Nga auditimi i ushtruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” për periudhën 01.01.2019 deri më datën 30.06.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 76, datë 17.05.2023, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë në AMA me shkresën nr.896/8, datë 18.05.2023, rezulton se:

**I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j)**

**të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.**

Subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.1604/2 datë 05.06.2023 kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

*Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor përkthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve*

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit).**

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, AMA është duke përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari brenda afatit 6 muajor, sikundër specifikohet në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30, pika 2 e tij.

*Sa më sipër rezulton se nuk është maturuar afati 6 muajor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, arsye për të cilën subjekti është në procedurën e përgatitjes së planit të masave lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.*

**III. Realizimi i rekomandimeve**

Nga ana e KLSH-së, janë lënë masat si më poshtë vijon: **1** propozim për ndryshim apo përmirësim në legjislacionin në fuqi, **26** masa organizative, **1** masë për shpërblim dëmi, **1** masë administrative, **6** masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike dhe **1** masë disiplinore.

*Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:*

a- Për përmirësimin e gjendjes është lënë **1** masë propozim për ndryshime apo përmirësim në legjislacion dhe efektet nënligjore në fuqi nga ku **2** rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit

- **2 rekomandime** janë zbatuar.

b- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **26** Masa organizative nga ku **35** rekomandime, të cilat janë pranuar **35** dhe kanë statusin si më poshtë vijon:

- **25 rekomandime** janë zbatuar, **9** janë në proces zbatimi dhe **1** është e pazbatuara.

c- Për përmirësimin e gjendjes është lënë **1** Masë shpërblim dëmi nga ku **1** rekomandim, i cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin si më poshtë vijon:

- **1 rekomandim** është zbatuar

d- Për përmirësimin e gjendjes është lënë **1** Masë Administrative nga ku **1** rekomandim, i cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin si më poshtë vijon:

- **1 rekomandim** është zbatuar

e- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **6** Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike nga ku **6** rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon,

- **6 rekomandim** në proces zbatimi.

f- Për përmirësimin e gjendjes është lënë **1** Masë Disiplinore nga ku **1** rekomandim, i cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon,

- **1 rekomandim** zbatuar

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

## **A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN DHE AKTET NËNLIGJORE NË FUQI**

**1.1. Rekomandimi:** Nga ana e AMA të merren masat për përmirësimin e kuadrit nënligjor në fuqi, (duke mbajtur parasysh miratimin me datën 13.04.2023, nga ana e Kuvendit të RSH-së, të projekt-ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 ‘Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar), nëpërmjet përmirësimit /shfuqizimit të:

- Rregullores së Autoritet të Mediave Audiovizive, miratuar me vendimin nr. 209, datë 16.09.2016 të Bordit, e cila në Nenin 27 të saj, ka të përfshirë “Sekretariatit Teknik të Autoritetit të Mediave Audiovizive”, dhe të
- Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Sekretariatit Teknik të AMA-s dhe përcaktimin e masës së pagesës në Sekretariatit Teknik”, miratuar me Vendimin e AMA nr.248, datë 21.12.2016.

Bordi i AMA-s të bashkërendojë dhe harmonizojë këto akte nënligjore me kërkesat e ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**1.2. Rekomandimi:** Nga ana e AMA të merren masat për shfuqizimin e Urdhrit nr. 111, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e nëpunësve në Sekretariatit Teknik”, i ndryshuar dhe të kryhet veprimtaria e institucionit në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 97/2013 i ndryshuar dhe në bashkërendim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

## **B. MASA ORGANIZATIVE:**

**1.1. Rekomandimi:** Duke patur parasysh rëndësinë e këtij procesi për të pasqyruar vlerën e drejtë të këtij aktiviteti në pasqyrat financiare të institucionit, pasaktësitë e informacionit të mbartur në Autoritetin e Mediave Audiovizive për vlerën e kësaj godine, Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që aktivitetet afatgjata materiale në administrim të institucionit të AMA të pasqyrohen me vlerën e drejtë e të saktë në kontabilitetin e institucionit. Për sa sipër, të merren masat për transferimin me dokumentacion të vlerës së Aktivitetit dhe kryerjen e një procesi vlerësimi të pavarur, duke përcaktuar vlerën e objektit, vlerën e amortizimit dhe regjistrimin e tyre në kontabilitet, duke evidentuar vlerën e drejtë në kontabilitet në llogarinë 212 “Ndërtesa”, në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16 “Aktivitet Afatgjata Materiale” dhe nga ana e Nëpunësit Zbatues të kryhen regjistrimet e vlerës së re të aktiveve të institucionit sipas VKM Nr.468, datë 03.06.2015.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**2.1. Rekomandimi:** Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme të ngrejë një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane, të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe pas përlllogaritjes së vlerave nga ekspertët e fushës, të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**2.2. Rekomandim:** Për një pasqyrim të drejtë në kontabilitet të vlerës së llogarisë “*Toka, troje dhe terrene*” në pronësi dhe administrim të AMA, bëhet domosdoshmëri azhurnimi, rakordimi dhe pasqyrimi në kontabilitetin e AMA-s i vlerave të kësaj pasurie, bazuar në informacionin e administruar nga vlerësuesit e pavarur.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*

**3.1. Rekomandimi:** Institucioni i AMA-s të marrë masat e menjëhershme për kryerjen e një analize të thelluar të debitorëve dhe të drejtave për arkëtim të regjistruar në kontabilitet, hartimin e planeve konkrete për ndjekjen dhe vendosjen e tyre në kushtet e arkëtimit, sidomos në kushtet që një pjesë e madhe e tyre kërcënohen nga risku i parashkrimit. Ky proces të shoqërohet me nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësi të rritjes së tyre.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet nga subjekti *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

**3.2. Rekomandimi:** Të merren masat që të evidentohen në mënyrë kontabël, të gjitha detyrimet financiare të angazhimit dhe ato të konstatuara në zbatim të kërkesave ligjore, me qëllim njohjen e detyrimeve financiare në kohën e krijimit, programimin e likuidimit të detyrimeve ndaj të tretëve dhe zvogëlimin e borxhit financiar. Nëpunësi zbatues, i cili sipas ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet, (neni 12, pika 2, germa “g”), është përgjegjës për: “garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të pa arkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mblidhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij...”, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të AMA-s, të marrin dhe të kërkojnë në rrugë zyrtare e gjyqësore arkëtimin e debive, nëpërmjet ngritjes së padisë me qëllim arkëtimin e këtyre detyrimeve.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet nga subjekti *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

**3.3. Rekomandimi:** Të hartohet dhe miratohet Gjurma e Auditimit për ndjekjen, regjistrimin dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për institucionin e AMA-s. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, në çdo rast, me marrjen dijeni për vendimet gjyqësore të formës së prerë në favor të ish-punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna, të marrë masat

për likuidimin në kohë të këtyre detyrimeve që lindin nga këto vendime gjyqësore dhe mos lejojnë krijimin e kostove shtesë apo shpenzimeve të panevojshme për pagesat e përmbaruesve gjyqësorë. Kjo në përputhje me kërkesat e legjislacionit për kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave publike, udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet nga subjekti *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

**4.1. Rekomandim:** Institucioni të ndjekë hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit për procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese, duke bërë të mundur kështu përfundimin e procesit të inventarizimit si dhe heqjen nga kontabiliteti referuar masave të cilat do merren për aktivet e vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**5.1. Rekomandim:** Bazuar në faktin se, në llogarinë 202 “Studime dhe projekte” janë përfshirë dhe përktihme, anketime, etj., kërkohet një vlerësim të kujdesshëm mbi domosdoshmërinë dhe argumentimin e përfshirjes së tyre në kategorinë e investimeve për “studime dhe anketime”; institucioni të adresojë prioritetet e planifikuara sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor mbi menaxhimin e financave publike, në harmoni me afatet kohore të përcaktuara me qëllim që të sigurojnë një shpenzim efikas dhe efektiv të buxhetit të planifikuar duke gjykuar rast pas rasti, mbi vlerat, dobinë dhe domosdoshmërinë e projekteve të përzgjedhura; duke arsyetuar nëse një zë apo projekt duhet të përfshihet në grupin e aktiveve afatgjata jo materiale, apo duhet kategorizuar si “shpenzime të ushtrimit”; si dhe vendimmarrja e AMA të mbështetet në analiza të mjaftueshme dhe në një dokumentim të plotë të kostos së këtyre projekteve.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**5.2. Rekomandim:** Gjatë hartimit të buxhetit të AMA-s, drejtoritë përgjegjëse, të identifikojnë nivelin e zbatimit të këtyre projekteve/objektivave, në mënyrë që këto projekte të aprovohen në bordin e AMA-s, dhe në vijimësi të merren në analizë për vonesat apo mosrealizimet e tyre. Projekt propozimet për investime të përmbajnë të gjitha informacionet e kërkuara sipas Programit për Investimet Publike dhe ky proces planifikimi i aktiviteteve të diskutohet dhe kalojë në filtrat e brendshëm të drejtorive deri në analizimin nga ana e Grupit të Menaxhimit Strategjik të AMA-s, me qëllim realizimin e projekteve më të domosdoshme, më të dobishme dhe me impakt, si dhe të ndihmojnë në zvogëlimin e devijimeve mes planifikimit fillestar dhe realizimit të buxhetit të AMA-s për këto zëra.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**6.1. Rekomandim:** Nga ana e Bordit të AMA-s, të merren masat që hartohet dhe miratohet dokumenti i Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Riskut për vitet 2023-2025.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**6.2. Rekomandim:** Shërbimet e AMA-s të marrin masat për hartimin e regjistrit të riskut për gjithë drejtoritë e institucionit si dhe të plotësojnë, azhurnojnë dhe përditësojnë Regjistrin e Riskut për programe dhe objektiva specifike 2 (dy) herë në vit, në përputhje me kërkesat e pikës nr. 3.2.5 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**7.1. Rekomandim:** Nga ana e AMA-s, të merren masat për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Riskut (EMR), të caktohet Koordinatori i Deleguar të Riskut dhe Menaxhimit Financiar e Kontrollit (KDR; KDMFK), si dhe të hartohet e miratohet nga bordi i AMA, dokumenti i planit të veprimit të kontrollit të brendshëm për vitin 2023 dhe gjurma e auditimit për proceset dhe veprimtaritë kryesore institucionale.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**8.1. Rekomandim:** Nga ana e Drejtorisë të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të hartohen plane konkrete pune në bashkëpunim me përgjegjës të strukturës së Sekretari - Arkivit dhe të ndiqet respektimi i normativës për punën me dokumentet. Gjithashtu, të merren masat që të njihet gjithë personeli që krijon dokumente me VKLA nr.4/2017 mbi dokumentin e njehsuar, të regjistrohen evidencat në regjistrin e korrespondencës mod.1 të gjithë dokumenteve të krijuara e të ardhura në institucion; të saktësohet në urdhra/ rregullore, përgjegjësia e materialit arkivor, të mos futen dokumente në arkiv të papërpunuara, të pa inventarizuara dhe pa procesverbal, si dhe të hapen regjistrat për shfrytëzimin e dokumenteve (mod.15).

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**9.1. Rekomandim:** Nga ana e Kryetarit të AMA të merren masat për hartimin dhe depozitimin tek nëpunësi i parë autorizues, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit pasardhës, të Pyetësorit të Vetëvlerësimit, Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm të kësaj njësie publike, për vitin e mëparshëm dhe të Planit të Veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

**Komenti i grupit të auditimit:** Në kushtet e ndodhjes brenda afatit ligjor (fundi i muajit shkurt të vitit pasardhës) grupi i auditimit, nuk mund të shprehet me siguri të arsyeshme mbi zbatueshmërinë e këtij rekomandimi. Sa më sipër, mbetet për t'u verifikuar rast pas rasti. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**9.2. Rekomandim:** Të merren masat nga ana e titullarit të AMA-s, që në çdo rast të delegimit të autoritetit, procedurat e delegimit, të shoqërohen me raportimin mbi realizimin e detyrave të deleguara, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe kuadrit

ligjor e nënligjor mbi menaxhimin e financave dhe kontrollin e brendshëm publik.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**10.1. Rekomandim:** Institucioni i AMA-s të marrë masat e duhura për administrimin e pasqyrave financiare të ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, (shoqëri apo persona fizik të licencuar/ autorizuar nga AMA), në përmbushur detyrimet ligjore referuar përcaktimeve të nenit 33 "Detyrimet e OSHMA-ve", të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar si dhe të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**10.2. Rekomandim:** Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, në çdo rast, të mosveprimit nga ana e ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, (shoqëri apo persona fizik të licencuar/ autorizuar nga AMA), për depozitimin e Pasqyrave Financiare të llogaridhënies vjetore të fillojë procedurat administrative "Për dënimin me gjobë", në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**11.1. Rekomandim:** Nga ana e strukturave përgjegjëse të Autoritetit të Mediave Audiovizive të merren masat që, të ndiqet me prioritet në gjykatë çështja e padisë së ngritur nga shoqëria "M." sh.a me nr.2981 akti, ku pretendohet dëmi i shkaktuar nga mos përmbushja e detyrimeve të përcaktuara në vendimin nr. 2819, dt. 22.12.2011 të Gjykatës së Apelit.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**11.2. Rekomandim:** Strukturat përgjegjëse të AMA-s të marrin masa që shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, të bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes, duke shmangur kështu kostot e përmbartimit të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**11.3. Rekomandim:** Nga ana e DSHB të AMA të përllogariten provizionet për rreziqe e dëmtime, në kuadër të procesit të përgatitjes së pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore për vitin 2023, sipas përcaktimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 6 "Provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara".

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar***.

**12.1. Rekomandim:** AMA të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për hartimin e planit të përdorimit të frekuencave sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar***.

**13.1. Rekomandim:** Nga ana e AMA-s në çdo rast të mbledhjeve të bordit të ndërmerren masat për të administruar procesverbalet e mbledhjeve sipas përcaktimeve ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar***.

**14.1. Rekomandim:** AMA të marrë masat për shqyrtimet e aplikimeve brenda afateve ligjore dhe të mos ketë vendimmarrje në tejkalim të afateve ligjore në fuqi. Në të gjithë rastet e vendimmarrjes në tejkalim të afateve ligjore në fuqi të nxirret përgjegjësia individuale e zyrtarëve.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar***.

**15.1. Rekomandim:** AMA të marrë masat ligjore në rastet e evidentimit të shkeljeve në lidhje me zbatimin e procedurave të shqyrtimit të ankesave, nga ana e Këshillit të Ankesave.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar***.

**16.1. Rekomandim:** Drejtoria e Shërbimeve të Brendshëm dhe Sektori i Financës të marrë masa që, në të gjitha praktikat për udhëtime e dieta për jashtë shtetit, dokumentit për kryerjen e pagesave t'i bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda përkatëse.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar***.

**17.1. Rekomandim:** Titullari i Autoritetit të Mediave Audiovizive të analizojë rastin dhe në vijimësi të marrë masa për trajtimin e barabartë të punonjësve në rastin e shpërblimeve financiare, ose përndryshe, të dokumentojë dhe argumentojë rastet kur trajtimi është i ndryshëm bazuar në performancë individuale të punonjësit apo shkaqe të tjera të argumentuara.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar***.

**18.1. Rekomandim:** Nga ana e financës të mbahen akt rakordime të përmuajshme me magazinën, për fletëdaljet e karburantit dhe përputhshmërinë e tyre me "urdhrat e dorëzimit" për të bërë të mundur kontrollin me efektivitet të shpenzimit të karburantit. Komisionet e ngritura për kronometrimin e harxhimit të karburantit për km e përshkuara si dhe drejtuesit të



bëjnë kronometrimin e harxhimit të karburantit si për lëvizjet urbane dhe ato interurbane. Në të gjitha rastet fletë udhëtimet të plotësohen për km e përshkruar dhe në përfundim të shërbimit të firmosen nga drejtuesi i automjetit dhe nga personat që kryejnë shërbimin me këtë automjet. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme të marrë masa që çdo fletë-udhëtimi e dorëzuar nga shoferët në fund të muajit, të jetë e plotësuar në mënyrë të saktë me të gjithë elementet e nevojshme siç janë itinerari i udhëtimit të përshkruar, kilometrat e përshkruara, litrat e karburantit të harxhuar për itinerarin e udhëtimit, punonjësi i AMA-s në me të cilin ka udhëtuar shoferi për arsye pune si dhe nënshkrimi i tij.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**19.1. Rekomandimi:** Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël të marrë masa për hartimin e kriterëve në përputhje me objektin e prokurimit, në mënyrë që të sigurohet një trajtim i drejtë dhe i barabartë i OE, si dhe të nxitet pjesëmarrja dhe konkurrenca ndërmjet tyre .

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**20.1. Rekomandimi:** Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël të marrë masa për shmangien e vendosjes së kriterëve të pambështetura ligjërisht, të cilat çenojnë parimin e vlerësimit të ofertave bazuar në parimet e ekonomicitetit.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**21.1. Rekomandimi:** Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël të marrë masa ku të kualifikojë dhe shpallë fitues Operatorët Ekonomik pasi të plotësojnë çdo kriter të veçantë të vendosur nga AK në ftesën për ofertë.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**22.1. Rekomandimi:** Në institucionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, të merren masa në vazhdim nga ana e punonjësve të ngarkuar në komisione, për dokumentimin e plotë të proceseve si pjesë e dosjes së prokurimit publik.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**23.1. Rekomandimi:** Në vazhdim komisionet e marrjes në dorëzim të verifikojnë brenda afateve ligjore mallrat/shërbimet e realizuara nga kontraktuesit, me qëllim shmangien e pagesave mbi afatin 30 ditor dhe vonesave në raportimin e “Formularit të raportimit për zbatimin e kontratës”.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**24.1. Rekomandimi:** Të merren masa nga ana e Njësisë së Prokurimit që të verifikohet në vazhdimësi sigurimi i kontratës së përcjellë nga OE fitues, lidhur me vlefshmërinë e saj si

kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**25.1. Rekomandimi:** Në vazhdim nga ana e AMA-s të hartohen urdhrat përkatës të marrjes në dorëzim për çdo prokurim dhe zbatohen me korrektësi detyrimet mbi marrjen në dorëzim të mallrave apo ndjekjen dhe realizimin e shërbimit.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**26.1. Rekomandimi:** Në vazhdim të merren masa që çdo shkresë që krijohet nga subjekti shtetëror Autoriteti i Mediave Audiovizive si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, të evidencohen në regjistrin e korrespondencës sipas një numri referues të veçantë.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga auditimi me zgjedhje i regjistrin të protokoll-arkivit, u konstatua se për secilën shkresë hyrëse/dalëse, korrespondonte vetëm një numër protokollit. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**C. MASA PËR SHPËRBLIMIN E DËMEVE:**

**1.1. Rekomandimi:** Nga AMA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 174,120 lekë, nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, për skualifikim të padrejtë të OE me ofertë me të ulët në procedurën e vitin 2020 "Kërkesë për Prokurimin e një serveri backup".

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**D. MASA ADMINISTRATIVE:**

**1.1. Rekomandimi:** Nga ana e Autoritetit të Mediave Audiovizive të merren masat për vendosjen e sanksioneve ligjore, duke mbajtur parasysh përcaktimet e Kreut XIV "Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet", Neni 132 "Masat për shkeljet", pika 2 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, ku është sanksionuar se "AMA vendos sanksionet e parashikuara në ligj jo më vonë se një vit nga data e kryerjes së shkeljes", ndaj të fillojë procesi i dhënies së masave administrative (gjobë), për 3 (tre) subjekte me nga 40 mijë deri në 400 mijë lekë për ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, shoqëri apo persona fizik të licencuar/ autorizuar nga AMA që janë brenda këtij afati.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E MENAXHIMIN PA EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE APO TË ARDHURA TË MUNGUARA.**

**1.1. Rekomandimi:** Nga Autoriteti i Mediave Audiovizive të merren masa për analizimin e përgjegjësisë dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, të rezultuara si

pasojë e një akti të paligjshëm, në deri më 30.06.2022.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**2.1. Rekomandimi:** Nga Autoriteti i Mediave Audiovizive të merren masa për analizimin e përgjegjësi dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike, të rezultuara si pasojë e një akti të paligjshëm, në shumën prej 12,240 mijë lekë për periudhën 1.1.2019 deri më 30.6.2022.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**3.1. Rekomandimi:** Nga Autoriteti i Mediave Audiovizive të merren masa për analizimin e këtyre rasteve si dhe nxjerrjen e përgjegjësi, me qëllim parandalimin dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara në të ardhurat e munguara dhe menaxhimin pa efektivitet të fondeve publike, të rezultuara si pasojë e veprimeve në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi për periudhën objekt auditimi.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**4.1. Rekomandimi:** Autoriteti i Mediave Audiovizive të analizojë me përgjegjësi procedurat e masave administrative të marra, në lidhje me ndryshimet e pronësisë, të cilat më pas janë shfuqizuar nga AMA, pas ankimeve të paraqitura, për periudhën 2019 - 2022, me qëllim parandalimin dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike, në shumën prej 1.360.000 lekë për periudhën 01.01.2019 deri më 30.06.2022. Autoriteti i Mediave Audiovizive, në shqyrtimet e ankimeve administrative mbi masat administrative ndaj OSHMA, të mbështet në dispozitat ligjore dhe të tregojë objektivitet në shqyrtimin e tyre. AMA të ndërmarr nismën për miratimin e një politike/ akti nënligjor për rastet e ndryshimeve në pronësi brenda të njëjtës shoqëri.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**5.1. Rekomandimi:** Nga Autoriteti i Mediave Audiovizive të merren masa për analizimin e përgjegjësi dhe parandalimin e eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike, të rezultuara si pasojë e një akti të paligjshëm, në shumën prej 4,181,090 lekë, pasi vendimet gjyqësore janë pagesa në mospërputhje me parimet e eficientë, efektivitetit dhe ekonomikitetit dhe që kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e AMA-së.

Autoriteti i Mediave Audiovizive të analizojë me përgjegjësi procedurat e largimit nga puna dhe të rekrutimit të punonjësve për periudhën 2019 - 2022, dhe të mbajë qëndrimet e duhura për përgjegjësitë individuale të zyrtarëve, për pasojat financiare që rezultojnë nga vendimmarrje të gabuara dhe pa shkaqe të arsyeshme e ligjore.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**6.1. Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit të Mediave Audiovizive të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të buxhetit të Autoritetit të Mediave Audiovizive në vlerën 217,461 lekë, mbi pagesat për orët jashtë orarit zyrtar.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

#### **F. MASA DISIPLINORE:**

Mbështetur në nenin 14 të ligjit nr. 97/2013, datë 4.3.2013 “Për mediat audiovizive”, i ndryshuar, nenin 59, pika i dhe 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, që në vlerësim të shkeljeve të konstatuara nga ana e grupit të auditimit, sipas pikës 1, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, të vlerësojë masën e shkeljeve dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara, sipas nenit 58, shkronja “a”, “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nga “vërejtje”, “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”; “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”; deri në, “Largim nga shërbimi civil”.

#### **Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

#### **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Nga auditimi i ushtruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” për periudhën 01.01.2019 deri më datën 30.06.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 76, datë 17.05.2023, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë në AMA me shkresën nr.896/8, datë 18.05.2023, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në kushtet e të qenurit brenda afatit 6 mujor që duhet për kthim përgjigje, grupi i auditimit nuk mund të shprehet mbi përmbushjen ose jo të këtij afati, por ngelet për tu vlerësuar pas periudhës 6 (gjashtë) mujore të detyrimit për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “*Ecuria e zbatimit të rekomandimeve*”:

Nr	Subjekti dhe lloji i masës	Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar			
			Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
<b>5</b>	<b>AMA</b>	<b>46</b>	<b>46</b>	<b>0</b>	<b>30</b>	<b>0</b>	<b>15</b>	<b>1</b>
	Propozime për ndryshim legjislativ	2	2	0	2	0	0	0
	Masa Organizative	35	35	0	25	0	9	1
	Masa Zhdëmtimi	1	1	0	1	0	0	0
	Masa Administrative	1	1	0	1	0	0	0
	Masa Disiplinore	1	1	0	1	0	0	0
	Masa për menaxhimin jo efektiv të fondeve	6	6	0	0	0	6	0
	<i>Masa për menaxhimin jo efektiv të fondeve (lekë)</i>	17.998.551	17.998.551				17.998.551	

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej **46** rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht ose në masën 100 %, dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht **30** rekomandime ose 65,22%

**Për sa më sipër ri kërkojmë që Autoriteti i Mediave Audiovizive të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024.**

*Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre.*

### **3.3 MINISTRIA E SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E BIZNESIT**

#### **PËRMBLEDHJE**

Në zbatim të Programit të Auditimit Nr. 900/1 Prot., datë 11.10.2023, “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, në ambientet e institucionit, më datë 25.10.2023, u mbajt aktverifikimi nr.3, datë 25.10.2023 nga audituesit e autorizuar të KLSH-së, znj. E. K. (p/grupi), znj. E. K.anëtare, me z. M.K., drejtor i Kabinetit, i autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së.

#### **Objekt i këtij akt verifikimi është:**

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën Nr. 792/9 Prot., datë 18.01.2023, për Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Mbi Auditimin e Përputhshmërisë*” të ushtruar në **Ministrinë e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit**, sipas programit të auditimit Nr. 792/2 Prot., datë 19.09.2022, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 30.06.2022, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. Znj. E. K. (Përgjegjësi i Grupit);
2. Znj. E. K., anëtar.

Auditimi ka filluar më, 11.10.2023.

Auditimi ka përfunduar më, 25.10.2023

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016, “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”.

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.900/1 prot., datë 11.10.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimi të rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

### **TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT**

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2017 deri më datën 30.06.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 15, datë 17.01.2023, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën Nr. 792/9, datë 18.01.2023, rezultoi se:

**I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.**

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka dërguar planin e veprimit me shkresën me nr. 1428 prot., datë 27.03.2023 me lëndë “Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiare” nga KLSH”, jashtë afatit ligjor 20 ditë, të përcaktuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

*Sa më sipër rezultoi se kthimi përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve është zbatuar jashtë afatit 20 ditor.*

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit).**

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit me shkresën nr.1428/2 datë 14.07.2023 ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 muaj, në zbatim të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.

*Sa më sipër rezultoi se është zbatuar afati 6 muaj për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve*

### **III. Realizimi i rekomandimeve**

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë konstatuar **në total 12 gjetje** për të cilat janë lënë **15 rekomandime**, nga ku **2 gjetje** për ndryshim apo përmirësim në legjislacionin

dhe aktet nënligjore në fuqi për të cilin janë lënë **2 rekomandime** si dhe **10 Masa Organizative** për të cilën janë lënë **13 rekomandime**.

*Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:*

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **2 Masa Ndryshim** apo Përmirësim Legjislacioni nga ku **2** rekomandim, të cilat janë pranuar plotësisht **2**, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **1** Zbatuar, **1** në proces zbatimi.
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **10 Masa organizative** nga ku **13** rekomandim, të cilat janë pranuar plotësisht **13** të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **5** Zbatuar, **2** në proces zbatimi dhe **6** pa zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në Kuvendin e Shqipërisë paraqitet si vijon:

## **A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN DHE AKTET NËNLIGJORE NË FUQI:**

**1.1. Rekomandimi:** Institucioni i Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në bashkëpunimin me Kryeministrinë, për të evituar përplasjet e mundshme të kompetencave dhe të fushës së përgjegjësisë zyrtare, me qëllim qartësimin e objektit të veprimtarisë, të marrë masat për hartimin dhe propozimin e përmirësimeve të nevojshme të kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, duke ngritur një grup pune për rishikimin dhe ridimensionimin e fushës së veprimtarisë, për të paraqitur sa më drejtë rolin, misionin, detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit, përmes ndryshimeve në VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i realizuar**.

**2.1. Rekomandimi:** Nga Ministria e Shtetit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes, të merren masat dhe të bëhen propozimet për përmirësimet e nevojshme të kuadrit ligjor në fuqi, përkatësisht të,

- pikës 4, të Nenit 14 “Mbështetja e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse”, të Ligjit nr. 25, datë 25.03.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, si dhe
- pikës 3, të Kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 315, datë 11.05.2022, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të kriterëve të procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij”,

duke synuar përmbushjen e qëllimeve, politikave dhe të objektivave të këtij institucioni shtetëror me kërkesat e ligjit “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të kontrollit të brendshëm, që siguron ndarjen e duhur të përgjegjësisë administrative që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe linjat e raportimit.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **proces zbatimi**.

## **B. MASA ORGANIZATIVE:**

**1.1. Rekomandimi:** Nga ana e institucionit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, të merren masat për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të institucionit, në përputhje me detyrimet që rrjedhin sipas pikës nr. 4/b, të VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, duke përcaktuar rregullat lidhur me organizimin, funksionimin e brendshëm dhe veprimtarinë e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, detyrat funksionale të përgjithshme dhe të veçanta të Kabinetit, metodat e brendshme të punës dhe mbarëvajtjen dhe disiplinën në marrëdhëniet e punës dhe etikën profesionale të stafit, procedurat e komunikimit ndërmjet tyre dhe Koordinatorit përkatës në Zyrën e Bashkëqeverisjes, etj. Dokumenti i rregullores së brendshme duhet të pasqyrojë rolin e MiSHMS në kuadër të Sekretariatit Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar”, funksione dhe veprimtari që kanë si bazë Ligjin nr. 57/2014 “Për Këshillin Ekonomik Kombëtar” të ndryshuar, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.281, datë 16.5.2018.

**Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**

**1.2. Rekomandimi:** Të merren masat për rishikimin dhe miratimin e Strategjisë për Ndërveprim mes Sipërmarrjes dhe Institucioneve Publike, bazuar në kompetencat dhe ridimensionimin e rolit dhe funksioneve të MiSHMS, jo vetëm si mekanizmi që u mundëson bizneseve të kanalizojnë dhe të advokojnë shqetësimet dhe propozimet e tyre për Qeverinë, por edhe si dhe një instrument për të ndërmjetësuar dhe lehtësuar komunikimin mes sipërmarrjes dhe institucioneve publike dhe për nxitjen e startup-eve.

**Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**2.1. Rekomandimi:** Të merren masat për ndjekjen në vijimësi të backlogut të ankesave të sipërmarrjes private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe të huaj, në proces shqyrtimi, të cilat janë të mbartura prej vitesh dhe shtrihen brenda juridiksionit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, si dhe atyre ankesave që janë dërguar për kompetencë në vijimësi nga ana e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, kur MiSHMS është institucioni përgjegjës për monitorimin, ndjekjen dhe trajtimin e çështjeve të regjistruara në seksionet e platformës “*Me ty për Shqipërinë që duam*”. Për sa sipër, në kuadër të promovimit të transparencës dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të sipërmarrjes, të publikohen rregullisht raportet mujore mbi ecurinë e shqyrtimit të këtyre ankesave.

**Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**3.1. Rekomandimi:** Nga institucioni i Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, të merren masat për përgatitjen dhe miratimin e gjurmës së auditimit të proceseve kryesore (të tilla si, skema e përfitimit / financimi i granteve për thirrjet e startupeve dhe lehtësuesve, promovimin e sipërmarrjes, ndjekjen e ankesave të subjekteve të biznesit me statusin në “Proces Verifikimi” që janë brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, koordinimin me hallkat e tjera të administratës dhe rolin në kuadër të sekretariatit të KEK, etj.).



### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**

**3.2. Rekomandimi:** Nga ana e MSHMS të merren masat për hartimin dhe depozitimin tek nëpunësi i parë autorizues, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit pasardhës, të Pyetëtorit të Vetëvleresimit, Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm të kësaj njësie publike, për vitin e mëparshëm dhe të Planit të Veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**

**4.1. Rekomandimi:** Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes të marrë masat që, hartimi i strategjisë së re institucionale, ku të përfshihen objektiva SMART (*specifikë, të matshëm, të arritshëm, të përshtatshëm dhe me kohë të përcaktuar*), të shoqërohet me plan-veprimet përkatëse të detajuara, ku të përcaktohet edhe metodologjia e monitorimit periodik të saj.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**5.1 Rekomandimi:** Të merren masat nga ana e Ministrit të Shtetit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes, që, në përputhje me përcaktimet e nenit 7, gërmat “c” dhe “ç”, të ligjit nr. 25/2022, datë 10.3.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, të koordinohen veprimet me ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë për planifikimin buxhetor të fondeve të startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta sipas kërkesave standarde të planifikimit buxhetor, me qëllimin e shmangies së praktikës së deritanishme të përdorimit të fondit rezervë për financimin e shpenzimeve të parashikuara në programin qeveritar të miratuar nga Kuvendi

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**5.2. Rekomandimi:** Në kushtet që, MiSHMS si një ministri pa portofol dhe me numër të reduktuar kapacitetesh (pesë punonjës), nuk ka në strukturë një funksion të dedikuar për financën, për kryerjen e planifikimit buxhetor të bashkëpunohet ngushtësisht me Kryeministrinë, konform parashikimeve të pikës nr. 27, të VKM Nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm” dhe mbi këtë bazë ti propozojë Këshillit të Ministrave miratimin e fondeve buxhetore për grantet dhe format e tjera të mbështetjes së startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

**6.1 Rekomandimi:** MSHMS në kuadër të rishikimit të strategjisë, të marrë masa mbi hartimin dhe reflektimin e një plani në lidhje me prioritetin përkatës së çdo thirrjeje për grant në funksion të krijimit të një procesi të adresuar të mbështetjes me grant.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

**7.1 Rekomandimi:** Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, të vlerësojë dhe marrë masat për përmirësimin e dokumentit të “Rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kryerjen e monitorimit, raportimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’u paraqitur nga startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve që aplikojnë për masa mbështetëse”, miratuar me urdhrin nr.3, datë 16.5.2022 të Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, pasi në rregulloren e grantit:

- a. Mungojnë filtrat e kontrollit paraprak të vlerësimit të dosjeve të çdo aplikanti për mbështetje me grante buxhetore, para shqyrtimit nga Komisioni i Vlerësimit;
- b. Nuk jepet asnjë detaj mbi mënyrën e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe sekretimit të vlerësimeve të kryera nga ana e çdo anëtari,
- c. Mungon përcaktimi nga ana e çdo anëtari të Komisionit të Vlerësimit, i nivelit të grantit për çdo përfitues startup ose lehtësues të kualifikuar si fitues;
- d. Nuk ka një përshkrim mbi mënyrën si do të klasifikohet aplikimi nga fitues në jofitues apo anasjelltas, kundrejt pikëve të vlerësuara nga komisioni i vlerësimit. Në rregulloren e grantit mungon kriteri i pikëve, nën të cilin aplikimi nuk kualifikohet, pasi është cilësuar se: *“Fituesit do të shpallen sipas renditjes së pikëve të mbledhura, në raport me fondin total në dispozicion.”*
- e. Mungon emërtimin specifik apo i përgjithshëm në lidhje me thirrjen për grant
- f. Mungon parashikimi mbi dokumentin justifikues që duhet të paraqesë çdo aplikant në mbështetje të formatit të buxhetit për çdo projekt konkurrues.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**

**8.1. Rekomandimi:** Nga MSHMS të merren masat që të përmirësohet mënyra e vlerësimit në *mënyrë individuale e të pavarur*, e çdo aplikimi nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Mbështetjes me Grant të Startup-eve dhe Lehtësuesve të Startup-eve, si dhe të dokumentohet me procesverbal të veçantë dhe protokollohet çdo mbledhje e Komisionit sipas standardeve të parashikuara për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

**9.1 Rekomandimi:** MSHMS të marrë masa që në përmbushjen e detyrës së menaxhimit të grantit të emërojnë punonjës me funksione administrative konform dispozitave ligjore në fuqi.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**10.1. Rekomandimi:** MSHMS të marrë masa për përmirësimin e regjistrimit të startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve me fokus si më poshtë:

- a) Në eliminimin e dublikimeve të pasaportave të startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve;
- b) Në plotësimin me të dhënat parësore dhe dytësore të çdo mbajtësi të pasaportës;

- c) Në hartimin dhe vënien në përdorim të një manuali mbi organizimin dhe funksionimin e këtij regjistri;
- d) Në hartimin e një dokumenti hardcopy të regjistrimit të startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve në funksion të ruajtjes të formës së pandryshuar konform vitit të cilit i përkon.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**

### **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka dërguar planin e veprimit me shkresën me nr. prot.,1428 datë 27.03.2023 me lëndë “Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike–financiare” nga KLSH”, *jashtë afatit ligjor 20 ditë, të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”* nenit 15, shkronja j. Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit me shkresën nr.1428/2 datë 14.07.2023 *ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në zbatim të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”* nenit 30.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “*Ecuria e zbatimit të rekomandimeve*”

Subjekti dhe lloji i masës	Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar			
		Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
<b>Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit</b>	<b>15</b>	<b>15</b>	<b>-</b>	<b>6</b>	<b>-</b>	<b>3</b>	<b>6</b>
Propozime për ndryshim legjislativ	2	2	-	1	-	1	-
Masa Organizative	13	13	-	5	-	2	6

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 15 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht ose në masën 100 %, dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 6 rekomandime ose në masën 40%.

**Për sa më sipër ri kërkojmë që Ministri Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar, brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024**

*Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre.*

### **3.4 MINISTRI SHETIT PËR RININË DHE FËMIJËT**

#### **PËRMBLEDHJE**

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.900/1 prot., datë 11.10.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, në ambientet e institucionit, më datë 25.10.2023, u mbajt aktverifikimi nr.4, datë 25.10.2023 nga audituesit e autorizuar të KLSH-së E. K.(përgj grupi), znj. E. K. anëtare, për Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët me znj. A. T. të autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të

KLSH-së dhe për Agjencinë Kombëtare të Rinisë me z. A. K. në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe znj. J. Sh. të autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së.

**Objekt i këtij akt verifikimi është:**

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.791/12 Prot, datë 24.01.2023 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi Auditimin e Përputhshmërisë” të ushtruar në Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, sipas programit të auditimit nr.792/2 Prot., datë 19.09.2023, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 30.06.2022, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.791/13 Prot, datë 24.01.2023 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi Auditimin e Përputhshmërisë” të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Rinisë, sipas programit të auditimit nr.792/2 Prot., datë 19.09.2023, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 30.06.2022, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. E. K. (P/ Grupit)

2. E. K., anëtar

Auditimi ka filluar më, 11.10.2023

Auditimi ka përfunduar më, 25.10.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.900/1 prot., datë 11.10.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimi të rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronike institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”.

**TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT**

Nga auditimi i ushtruar në Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2017 deri më datën 30.06.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 25, datë 20.01.2023, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 791/13, datë 24.01.2023, verifikohet se:

**I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.**

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka dërguar planin e veprimit me shkresën me nr. 4978/10 prot., datë 14.02.2023 me lëndë “Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike –

financiare”nga KLSH”, *jashtë afatit ligjor 20 ditë, të përcaktuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.*

*Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 20 ditor përkthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.*

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.**

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët **nuk** ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 muajor, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.

*Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 6 muajor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve*

**Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Rinisë** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2017 deri më datën 30.06.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 25, datë 20.01.2023, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 791/13, datë 24.01.2023, rezultoi se:

**I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.**

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka dërguar planin e veprimit me shkresën me nr. 35/1 prot., datë 14.02.2023 me lëndë “Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike –financiare” nga KLSH”, *jashtë afatit ligjor 20 ditë, të përcaktuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.*

*Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 20 ditor përkthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.*

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.**

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Rinisë **nuk** ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 muajor, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.

*Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 6 muajor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve*

### **III. Realizimi i rekomandimeve**

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë konstatuar në total **10 gjetje** për të cilat janë lënë **11 rekomandime**, nga ku **8 Masa Organizative** për të cilën janë lënë **9**

**rekomandime** dhe **1** Masa për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore për të cilin është lënë **1 rekomandim** dhe **1 Masë Disiplinore** për të cilin është lënë **1 rekomandim**.

*Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:*

- Për përmirësimin e gjendjes është lënë 8 Masë organizative nga ku **9** rekomandim, të cilat janë pranuar plotësisht **9** të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **8** Zbatuar, **1** në proces zbatimi.
- Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 rekomandim për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore, i cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë **në proces zbatimi**.
- Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë Disiplinore e cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë **pa zbatuar**.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në Ministrinë e Kulturës paraqitet si vijon

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.1 Rekomandimi:** Nga ana e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët të merren masa të menjëhershme lidhur me hartimin dhe publikimin e raporteve të vlerësimit të situatës së të rinjve, monitorimi i politikave dhe veprimtarive rinore, monitorimi i standardeve për ndërtimin e hapësirave rinore, duke dhënë në këtë mënyrë një vlerësim aktual mbi situatën reale të të rinjve në Republikën e Shqipërisë.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

**2.1 Rekomandimi:** Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**3.1 Rekomandimi:** Nga ana e strukturës përgjegjëse për monitorim, në AKR, të merren masa për hartimin e një plani monitorimi periodik, dhe përfaqësues, dhe me objektiva të qarta për projektet në fushën e Rinisë, me qëllim vlerësimin e përdorimit të fondeve publike në këto programe, me efikasitet dhe efektivitet.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**4.1 Rekomandimi:** Nga ana e strukturës përgjegjëse në AKR, në vijimësi të merren masa për respektimin e afateve të pagesave të kësteve dhe të shtyrjes të afatit të përfundimit të projektit sipas kontratës së lidhur midis AKR-së dhe organizatave.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**5.1 Rekomandimi:** Titullari i institucionit të AKR-së të marrë masa për krijimin Ekipit të Menaxhimit të Programit, hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm së bashku me formatet e raporteve të PBA-së, çdo vit, me qëllim për të mundësuar një planifikim sa më real të shpenzimeve korrente dhe investimeve, për përmbushjen e objektivave të institucionit.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**5.2. Rekomandimi:** AKR-ja të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit për çdo katër muaj, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimit sa më efektiv të fondeve buxhetore.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**6.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.

**Komenti i grupit të auditimit.** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**7.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa që të hartojë një format tip që përfshin të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punës dhe të lidhë Kontrata Individuale të Punës me secilin nga punonjësit e institucionit.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**8.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët të marrin masa për përditësimin e rregullores sipas ndryshimeve të ndodhura në organikën dhe strukturën e AKR-së.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1.1 Rekomandimi:** Nga MSHRF dhe AKR të merren masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e shkaqeve që kanë sjellë mos fillimin e implementimit të projekteve të bashkive, referuar kontratave së lidhur midis AKR-së dhe Bashkive Tiranë, Elbasan, Lezhë duke rrezikuar përdorim jo efektiv të fondeve prej 15,508,295 lekë.

**Komenti i grupit të auditimit** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

### C. MASA DISIPLINORE, ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA

Mbështetur në nenin 15, shkronja c dhe nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që, në përputhje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të vlerësojë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të përfshirë, në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të kërkojë marrjen e masave për personat që vlerësohen me përgjegjësi në këtë raport përfundimtar auditimi.

#### Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

### KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i ushtruar në **Ministrisë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2017 deri më datën 30.06.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 25, datë 20.01.2023, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 791/13, datë 24.01.2023, rezultoi se subjekti nuk ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Subjekti *nuk ka përgatitur planin e masave te marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.*

Nga auditimi i ushtruar në **Agjencinë Kombëtare të Rinisë** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2017 deri më datën 30.06.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 25, datë 20.01.2023, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 791/13, datë 24.01.2023, rezultoi se:

subjekti ka dërguar planin e veprimit me shkresën me nr. 35/1 prot., datë 14.02.2023, *jashtë afatit ligjor 20 ditë, të përcaktuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j. Subjekti audituar nuk ka përgatitur planin e masave te marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.*

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve”

Subjekti dhe lloji i masës	Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar			
		Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
<b>Ministër Shteti për Rininë dhe Fëmijët &amp; Agjencia Kombëtare e Rinisë</b>	<b>11</b>	<b>11</b>	<b>0</b>	<b>8</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>1</b>
Masa Organizative	9	9	0	8	0	1	0
Masa Disiplinore	1	1	0	0	0	0	1



Masa për menaxhimin jo efektiv te fondeve	1	1	0	0	0	1	0
---	---	---	---	---	---	---	---

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 11 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100%), dhe rezultojnë zbatuar plotësisht 8 rekomandime ose 72,73%.

**Për sa më sipër ri kërkojmë që Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024, për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pazbatuara, si më poshtë.**

*Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre.*

### 3.5 AGJENCIA KOMBËTARE TË RINISË

#### PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.900/1 prot., datë 11.10.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, në ambientet e institucionit, më datë 25.10.2023, u mbajt aktverifikimi nr.4, datë 25.10.2023 nga audituesit e autorizuar të KLSH-së E.K. (përgjegjëse grupi), znj. E. K. anëtare, për **Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët** me znj. A.T. të autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së dhe për **Agjencinë Kombëtare të Rinisë** me z. A. K. në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe znj. J. Sh. të autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së.

#### **Objekt i këtij akt verifikimi është:**

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.791/12 Prot, datë 24.01.2023 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Mbi Auditimin e Përputhshmërisë*” të ushtruar në **Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët**, sipas programit të auditimit nr.792/2 Prot., datë 19.09.2023, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 30.06.2022, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.791/13 Prot, datë 24.01.2023 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Mbi Auditimin e Përputhshmërisë*” të ushtruar në **Agjencinë Kombëtare të Rinisë**, sipas programit të auditimit nr.792/2 Prot., datë 19.09.2023, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 30.06.2022, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. E. K.i (P/ Grupit)

2. E. K., anëtar

Auditimi ka filluar më, 11.10.2023

Auditimi ka përfunduar më, 25.10.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.900/1 prot., datë 11.10.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të

Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronike institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”.

## **TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT**

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2017 deri më datën 30.06.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 25, datë 20.01.2023, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 791/13, datë 24.01.2023, verifikohet se:

**I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.**

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka dërguar planin e veprimit me shkresën me nr. 4978/10 prot., datë 14.02.2023 me lëndë “Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike –financiare” nga KLSH”, jashtë afatit ligjor 20 ditë, të përcaktuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

*Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.*

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.**

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët **nuk** ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 muajsh, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.

*Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 6 muajsh për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve*

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Rinisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2017 deri më datën 30.06.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 25, datë 20.01.2023, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 791/13, datë 24.01.2023, rezultoi se:

**I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.**

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka dërguar planin e veprimit me shkresën me nr. 35/1 prot., datë 14.02.2023 me lëndë “Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike –financiare” nga KLSH”, jashtë afatit ligjor 20 ditë, të përcaktuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

*Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 20 ditor përkthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.*

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.**

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Rinisë nuk ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.

*Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve*

### **III. Realizimi i rekomandimeve**

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë konstatuar në total 10 gjetje për të cilat janë lënë 11 rekomandime, nga ku 8 Masa Organizative për të cilën janë lënë 9 rekomandime dhe 1 Masa për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore për të cilin është lënë 1 rekomandim dhe 1 Masë Disiplinore për të cilin është lënë 1 rekomandim.

*Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:*

- Për përmirësimin e gjendjes është lënë 8 Masë organizative nga ku 9 rekomandim, të cilat janë pranuar plotësisht 9 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 8 Zbatuar, 1 në proces zbatimi.
- Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore nga ku 1 rekomandim është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë në proces zbatimi.
- Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë Disiplinore e cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë pa zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në Ministrinë e Kulturës paraqitet si vijon:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.1 Rekomandimi:** Nga ana e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët të merren masa të menjëhershme lidhur me hartimin dhe publikimin e raporteve të vlerësimit të situatës së të rinjve, monitorimi i politikave dhe veprimtarive rinore, monitorimi i standardeve për ndërtimin e hapësirave rinore, duke dhënë në këtë mënyrë një vlerësim aktual mbi situatën reale të të rinjve në Republikën e Shqipërisë.

#### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

**2.1 Rekomandimi:** Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

**Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**3.1 Rekomandimi:** Nga ana e strukturës përgjegjëse për monitorim, në AKR, të merren masa për hartimin e një plani monitorimi periodik, dhe përfaqësues, dhe me objektiva të qarta për projektet në fushën e Rinisë, me qëllim vlerësimin e përdorimit të fondeve publike në këto programe, me efikasitet dhe efektivitet.

**Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**4.1 Rekomandimi:** Nga ana e strukturës përgjegjëse në AKR, në vijimësi të merren masa për respektimin e afateve të pagesave të kësteve dhe të shtyrjes të afatit të përfundimit të projektit sipas kontratës së lidhur midis AKR-së dhe organizatave.

**Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**5.1 Rekomandimi:** Titullari i institucionit të AKR-së të marrë masa për krijimin Ekipit të Menaxhimit të Programit, hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm së bashku me formatet e raporteve të PBA-së, çdo vit, me qëllim për të mundësuar një planifikim sa më real të shpenzimeve korrente dhe investimeve, për përmbushjen e objektivave të institucionit.

**Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**5.2. Rekomandimi:** AKR-ja të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit për çdo katër muaj, ku të raportohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore.

**Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**6.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.

**Komenti i grupit të auditimit.** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

**7.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa që të

hartojë një format tip që përfshin të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punës dhe të lidhë Kontrata Individuale të Punës me secilin nga punonjësit e institucionit.

#### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**8.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët të marrin masa për përditësimin e rregullores sipas ndryshimeve të ndodhura në organikën dhe strukturën e AKR-së.

#### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

### **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1.1 Rekomandimi:** Nga MSHRF dhe AKR të merren masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e shkaqeve që kanë sjellë mos fillimin e implementimit të projekteve të bashkive, referuar kontratave së lidhur midis AKR-së dhe Bashkive Tiranë, Elbasan, Lezhë duke rrezikuar përdorim jo efektiv të fondeve prej 15,508,295 lekë.

**Komenti i grupit të auditimit** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

### **C. MASA DISIPLINORE, ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA**

Mbështetur në nenin 15, shkronja c dhe nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që, në përputhje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të vlerësojë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të përfshirë, në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të kërkojë marrjen e masave për personat që vlerësohen me përgjegjësi në këtë raport përfundimtar auditimi.

#### **Komenti i grupit të auditimit.**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

### **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Nga auditimi i ushtruar në **Ministrisë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2017 deri më datën 30.06.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 25, datë 20.01.2023, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 791/13, datë 24.01.2023, rezultoi se subjekti nuk ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Subjekti nuk ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.

Nga auditimi i ushtruar në **Agjencinë Kombëtare të Rinisë** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2017 deri më datën 30.06.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 25, datë 20.01.2023, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 791/13, datë 24.01.2023, rezultoi se:

subjekti ka dërguar planin e veprimit me shkresën me nr. 35/1 prot., datë 14.02.2023, jashtë afatit ligjor 20 ditë, të përcaktuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j. Subjekti audituar nuk ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “*Ecuria e zbatimit të rekomandimeve*”

Subjekti dhe lloji i masës	Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar			
		Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
<b>Ministër Shteti për Rininë dhe Fëmijët &amp; Agjencia Kombëtare të Rinisë</b>	<b>11</b>	<b>11</b>	<b>0</b>	<b>8</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>1</b>
Masa Organizative	9	9	0	8	0	1	0
Masa Disiplinore	1	1	0	0	0	0	1
Masa për menaxhimin jo efektiv të fondeve	1	1	0	0	0	1	0

Sa sipër rezultojnë se janë dhënë gjithsej 11 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë zbatuar plotësisht 8 rekomandime ose 72,73%.

**Për sa më sipër ri kërkojmë që Agjencia Kombëtare e Rinisë të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024, për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pazbatuara, si më poshtë:**

*Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre.*

### **3.6 AGJENCIA KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT**

#### **PËRMBLEDHJE**

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.900/1 prot, datë 11.10.2023. “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, në ambientet e institucionit, më datë 25.10.2023, u mbajt aktverifikimi nr. 5, datë 25.10.2023 nga audituesit e autorizuar të KLSH-së A. H. (K.) (përgjegjëse grupi) dhe z. A. M. anëtare, me përfaqësues nga ana e AKSHI-t znj. H.D. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe personit të autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së si dhe z. D. Sh. në cilësinë e Zv.Drejtorit të Përgjithshëm.

**Objekti i këtij aktverifikimi është:**

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.730/16 datë 03.05.2023 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e Përputhshmërisë” të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, sipas programit të auditimit nr.730/1 prot, datë 06.07.2021, i ndryshuar për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2021, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe nivelin e zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

A. K. (H.) (Përgjegjësi i Grupit)

A. M., anëtar

Auditimi ka filluar më, 16.10.2023

Auditimi ka përfunduar më, 25.10.2023

Auditimi është kryer në zbatim të Programit të Auditimit nr.900/1 prot, datë 11.10.2023. “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

## **TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT**

Nga auditimi i ushtruar në **Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit**, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e Përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2017 deri më datën 31.12.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 67, datë 28.04.2023, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë në AKSHI me shkresën nr.730/16, datë 03.05.2023, rezultoi se:

**I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.**

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka *miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH*, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.2143/1 datë 16.05.2023 kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

*Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.*

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit).**

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, AKSHI-t janë duke *përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari brenda afatit 6 muajor*, sikundër specifikohet në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30, pika 2 e tij.

*Në kushtet e të qenurit brenda afatit 6 mujor që duhet për kthim përgjigje grupi i auditimit nuk mund të shprehet mbi përmbushjen ose jo të këtij afati, por ngelet për tu vlerësuar në përmbushjet të periudhës 6 (gjashtë) mujore.*

### **III. Realizimi i rekomandimeve**

Nga ana e KLSH-së, janë lënë 24 masa organizative, 4 masa për shpërbllim dëmi, 4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike dhe 1 masë disiplinore.

*Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:*

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **21** Masa organizative nga ku **24** rekomandime, të cilat janë pranuar **24** dhe kanë statusin: **15** janë zbatuar, **9** janë në proces zbatimi.
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **4** Masa shpërbllim dëmi nga ku **4** rekomandime, cilat janë pranuar **4** dhe kanë statusin: **2** zbatuar pjesërisht dhe **2** janë të pazbatuara.
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **4** Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike nga ku **4** rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit: **2** janë zbatuar dhe **2** janë në proces zbatimi.
- Për përmirësimin e gjendjes është lënë **1** Masë Disiplinore nga ku **1** rekomandim, i cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit: **1** në proces zbatimi.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale paraqitet si vijon:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.1. Rekomandimi:** AKSHI të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore, ku të përcaktohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, si dhe në raportet 8 mujore të jepen informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit, si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore, si dhe ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve, si dhe duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.

#### **Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar*** .

**2.1. Rekomandimi:** AKSHI, si institucion ofrues i shërbimeve TIK, të marrë masa për ri konceptimin e marrëveshjeve aktuale të nënshkruara me institucionet duke vendosur në marrëveshje zërat specifikë dhe të detajuar të shërbimit që i ofrohen realisht institucioneve bazuar në specifikat që kanë.

#### **Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

**2.2. Rekomandimi:** AKSHI të marrë masa për dokumentimin si pjesë e marrëveshjes, të komunikimeve/ndërveprimit elektronik të të dhënave ndërtuar për secilin sistem të çdo



institucioni, ndarja e përgjegjësisë mbi këto të dhëna, mënyrat se si garantohen këto të dhëna si dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit në rast ndërprerje duke siguruar në këtë mënyrë institucionet përfituese të shërbimeve TIK për integritetin e të dhënave dhe ruajtjen e tyre.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar* .

**3.1. Rekomandimi:** AKSHI, si institucion dhënës i shërbimeve TIK, të marrë masa për dokumentimin e kontrolleve periodike që kryejnë specialistët e tij në institucionet ku ofrohen shërbime të TIK.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar* .

**3.2. Rekomandimi:** AKSHI të rishikojë dhe ripërcaktojë detyrat funksionale të punës që kryen çdo punonjës i AKSHI<sup>t</sup> që ofron shërbime TIK institucioneve publike, me qëllim përcaktimin saktë dhe të qartë të përgjegjësiave individuale, profesionale e institucionale që ka AKSHI ndaj institucioneve përfituese të shërbimit.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar* .

**4.1. Rekomandimi:** Titullari i institucioni, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim, përditësimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme dhe Kodin Etik për organizimin dhe funksionimin e institucionit referuar ndryshimeve që ka pësuar struktura vitet e fundit, me qëllim mirë funksionimin dhe mirë organizimin e institucionit në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe kushtetuese.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar* .

**5.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës në vijimësi të marrë masa për shlyerjen brenda afatit 30 ditor të detyrimeve të lindura, me qëllim shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

**Komenti i grupit të auditimit:** Grupi i auditimit për vlerësimin e statusit të këtij rekomandimi përzgjedhi 3 praktika Urdhër Shpenzimesh për të verifikuar shlyerjen brenda apo jo afatit 30 ditor të rekomandimeve.

U.SH nr.1099 datë 04.10.2023 ku fatura nr.98/2023 datë 22.09.2023 ; U. Sh nr.227 datë 13.03.2023 ku fatura nr.1726/15 datë 24.02.2023 dhe U. Sh nr.1069 datë 26.09.2023 ku fatura nr.427/2023 datë 06.09.2023.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar* .

**6.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës në vijimësi të marrë masa për plotësimin e praktikave të Urdhër shpenzimeve me dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si procesverbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletëhyrje origjinale, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**7.1. Rekomandimi:** Në vijimësi AKSHI të marrë masa për kryerjen procedurës së prokurimit për shërbime të cilat janë objekt i ligjit për prokurimin publik.

Spektori i Financës në vijimësi të marrë masa për mos likuidimin e faturave në mungesë të kontratave të lidhura.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**8.1. Rekomandimi:** Në vijimësi Spektori i Financës të konfirmojë çdo angazhim të ndërmarrë nga AKSHI, duke siguruar ekzistencën e fondeve, duke shmangur riskun për pagesat pjesore e për pasojë krijimin e detyrimeve të prapambetura.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**9.1. Rekomandimi:** Njësia e prokurimit në vijimësi të tregojë kujdes gjatë zhvillimit të procedurave me vlera të vogla, duke respektuar limitin total vjetor të mallrave të njëjta apo të ngjashme.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**10.1. Rekomandimi:** Spektori i Financës të marrë masa në vazhdimësi, që në momentin e pranimit të dokumentacionit financiar nga palët e treta, të bëjë regjistrimin kontabël duke kredituar llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në debi të llogarive të shpenzimeve dhe investimeve sipas detyrimeve të konstatuara.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**11.1. Rekomandimi:** Spektori i financës së AKSHI-it të marrë masa për sistemimin e shumës 59,872,164 lekë nga llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” në llogarinë 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”, zë në të cilën janë regjistruar “Datacenter-at”.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**12.1. Rekomandimi:** Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të AKSHI-it të analizojnë rezultatin e dalë nga komisioni inventarizimit dhe për diferencat e konstatuara, nga krahasimi i vlerës së aktiveve të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe atyre të rezultuara nga inventarizimi për llogarinë 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje” në vlerën prej 72,721,176 lekë, të nxjerrin arsyet dhe përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës.

- Nëpunësi Zbatues dhe Spektori i Financës së AKSHI-it të marrin masat, që përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit të aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të disponojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve, me qëllim evidentimin e saktë të vlerave të aktiveve në kontabilitet.

Gjithashtu të marrin masa për të analizuar dhe të argumentuar vlerën e reflektuar në llogarinë

214 “*Instalime Teknike makineri, pajisje*” më shumë prej (137,725,298) lekë, duke nxjerr arsyet dhe përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës.

Sa më sipërm bazuar në vendimmarrjen e këtyre strukturave të bëhen sistemimet në kontabilitet dhe për diferencat e paargumentuara ligjërisht të ndiqet masat në organet e tjera ligj zbatuese.

#### **Komenti i grupit të auditimit:**

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konkretisht Urdhër nr.485 datë 05.10.2023 “Për vlerësimin dhe analizimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit për drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të E-Gov dhe TIK dhe Shërbimeve Mbështetëse”.

Është specifikuar se duhen analizuar gjetjet 12-16 të Masa Organizative ku përshihet edhe rekomandimi i sipërcituar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***është në proces zbatimi***.

**13.1. Rekomandimi:** Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të AKSHI-it të analizojnë rezultatin e dalë nga komisioni inventarizimit dhe për diferencat e konstatuara, nga krahasimi i vlerës së aktiveve të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe atyre të rezultuara nga inventarizimi për llogarinë 24 “*Aktive afatgjata të dëmtuara*” në vlerën prej 5,676,269 lekë, të nxjerrin arsyet dhe përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës.

- Sektori i financës të marrë masa menjëherë, për sistemimin e shumës prej 1,564,222 lekë, duke debituar llogarinë përkatëse 218 ‘*Inventar ekonomik*’ dhe duke kredituar llogarinë përkatëse 24 “*Aktive afatgjata të dëmtuara*”.

- Sektori i financës të marrë masa për të sistemuar të gjithë aktivet e regjistruara në l24 “*Aktiveafatgjata të dëmtuara*”, pasi nuk kemi të bëjmë me aktive të dëmtuara po me aktive të cilat janë gjendje punë dhe janë të transferuara si kalim kapital pa pagesë nga institucionet e tjera.

#### **Komenti i grupit të auditimit:**

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konkretisht Urdhër shpenzime nr.485 datë 05.10.2023 “Për vlerësimin dhe analizimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit për drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të E-Gov dhe TIK dhe Shërbimeve Mbështetëse”.

Është specifikuar se duhen analizuar gjetjet 12-16 të Masa Organizative ku përshihet edhe rekomandimi i sipërcituar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***është në proces zbatimi***.

**14.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës së AKSHI-it të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve. Sektori i Financës së AKSH-it të marrë masa për kreditimin e llogarisë 214 ‘*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*’ në vlerën bruto prej 128,710,069 lekë dhe llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në vlerën bruto prej 11,7129,145 lekë dhe debitimin e llogarisë 219 “*Amortizimi i akumuluar i aktiveve afatgjata*” në vlerën 128,640,027 lekë dhe të llogarisë 24 “*Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara*”, për vlerën neto prej 11,793,187 lekë, të cilat janë vlerësuar jashtë përdorimi.

**Komenti i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konkretisht Urdhër nr.485 datë 05.10.2023 “Për vlerësimin dhe analizimin e rekomandimeve

të lëna në raportin përfundimtar të auditimit për drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të E-Gov dhe TIK dhe Shërbimeve Mbështetëse”.

Është specifikuar se duhen analizuar gjetjet 12-16 të Masa Organizative ku përshihet edhe rekomandimi i sipërcituar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***në proces zbatim***

**15.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar rezultatin e viti ushtrimor në llogarinë 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”, si dhe duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, të vitit paraardhës në llogarinë 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni”, për një pasqyrim më të drejtë të kundër partisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***në proces zbatimi*** .

**16.1. Rekomandimi:** Komisioni i vlerësimit i ngritur nga Titullari i Institucionit të AKSHI-it të marrë masa në vazhdimësi, që për çdo aktiv të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi, të mbajë procesverbale në vete, ku të përcaktohet shkaqet e daljes jashtë përdorimi të aktiveve, vlerën e mbetur të tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i tyre.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konkretisht Urdhër nr.485 datë 05.10.2023 “Për vlerësimin dhe analizimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit për drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të E-Gov dhe TIK dhe Shërbimeve Mbështetëse”.

Është specifikuar se duhen analizuar gjetjet 12-16 të Masa Organizative ku përshihet edhe rekomandimi i sipërcituar.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***në proces zbatimi***.

**17.1. Rekomandimi:** AKSHI të analizojë situatën e mësipërme, duke argumentuar zhvillimin e procedurës me negociim pa shpallje e cila është zhvilluar, jo në përputhje me kushtet e parashikuara në dispozitat ligjore, me qëllim shmangien e kësaj problematike në të ardhmen.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

**18.1. Rekomandimi:** Në përlllogaritjen e fondit limit, për procedurat e mirëmbajtjes të cilat përsëriten çdo 1 apo 2 vjet, AKSHI duhet të konsiderojë, analizojë, vlerësojë dhe argumentojë përlllogaritjen e vlerësimit bazuar në kontratat e ngjashme të cilat janë kontratat e mëparshme, me qëllim menaxhimin e fondeve të mirëmbajtjes në mënyrë sa më eficente dhe me ekonomikitet.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Nga auditimi me përzgjedhje i praktikave prej grupit të auditimi rezultoi se, ishte kryer analizë, dhe argumentim për llogaritjen e vlerës limit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**19.1. Rekomandimi:** AKSHI të analizojë rastet e audituara, si dhe të marrë masa për të vendosur dhe argumentuar specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Nga auditimi me përzgjedhje i praktikave prej grupit të auditimi rezultoi se, ishte kryer analizë, dhe argumentim për llogaritjen e vlerës limit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**20.1. Rekomandimi:** Titullari i institucionit, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim, përditësimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme dhe Kodin Etik për organizimin dhe funksionimin e institucionit referuar ndryshimeve që ka pësuar struktura vitet e fundit, me qëllim mirë funksionimin dhe mirë organizimin e institucionit në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe kushtetuese.

- Nga AKSHI, të merren masa për hartimin dhe miratimin e dokumentit institucional të gjurmës së auditimit si dhe zhvillimin dhe dokumentimin e takimeve të realizuara nga GMS.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**20.2. Rekomandimi:** Titullari i institucionit, të bëjë të mundur plotësimin e organikës me auditues me përvojë, në mënyrë që të sigurohet një monitorim dhe raportim i vazhdueshëm mbi aktivitetin financiar të institucionit.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**21.1. Rekomandimi:** AKSHI në bashkëpunim me AKUM, të analizojnë arsyet që kanë shkaktuar mos përdorimin e sistemit, duke marrë të gjitha masat për vënien në funksion të tij sipas qëllimit për të cilin u ndërtua.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Nga ana e AKSHI-t është përcjellë me shkresën nr. 2143/2 Prot., datë 17.10.2023 kërkesa drejtuar Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve për përcjelljes së dy përfaqësuesve për të qenë pjesë e grupit të punës.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1.1. Rekomandimi:** AKSHI të kërkojë në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 68,001 lekë nga “E. Shpk”. Kjo vlerë përbën dëm ekonomik

pasi është paguar për një furnizim të pa kryer.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet nga *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

**2.1. Rekomandimi:** AKSHI të kërkojë në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 903,076 lekë nga “A. Shpk”. Kjo vlerë përbën dëm ekonomik si pasojë e realizimit me vonesë të kontratës.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet nga *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

**3.1. Rekomandimi:** AKSHI të kërkojë në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimin e vlerës 876,072 nga operatori “I.”. Kjo vlerë përbën dëm ekonomik pasi kushtet e kontratës rezultojnë të pa përmbushura dhe të pakonfirmuara nga personat përgjegjës.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

**4.1. Rekomandimi:** AKSHI, të kryej verifikimin e zbatimit të kontratës si dhe të llogarisë diferencat midis TORS<sup>ave</sup> të kërkuara në marrëveshje/kontratë dhe sistemit të realizuar nga operatori “B.shpk” në rast se janë kryer apo ka ndryshime ku sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion janë në vlerën 17,497,938 lekë me TVSH. Pas verifikimit dhe kontrollit të realizimit dhe funksionimit të sistemit, dhe në rast të konfirmimit të mosplotësimit të të gjitha kushteve të kontratës nga kontraktori të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 17,497,938 lekë me TVSH nga operatori “B.shpk”, duke e konsideruar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit pasi kushtet e kontratës rezultojnë të pa përmbushura dhe të pakonfirmuara nga personatpërgjegjës.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

**C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1.1. Rekomandimi:** AKSHI të analizojë situatën lidhur me përlllogaritjen e gabuar të fondit limit, duke marrë masat e duhura për parandalimin e krijimit të efekteve financiare negative në të ardhmen.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**2.1. Rekomandimi:** AKSHI të analizojë arsyet që kanë shkaktuar mos përdorimin e sistemit, duke marrë të gjitha masat për vënien në funksion të tij sipas qëllimit për të cilin u ndërtua.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar* .

**3.1. Rekomandimi:** AKSHI të marrë masa dhe të analizojë rastin me qëllim që në të ardhmen, të mos marrë në dorëzim jashtë afateve projekte/produkte, pa përcaktuar dhe kërkuar më parë përlllogaritjen dhe mbajtjen e penalteteve ndaj. Për praktikën, të nxjerrë përgjegjësitë për moskërkimin dhe arkëtimin nga subjekti “B. shpk” të penalteteve për vonesa në dorëzimin në afat të produktit, sipas kontratës me nr. 2497 prot., datë 13.05.2019.

**Komenti i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konkretisht Urdhër nr.484 datë 05.10.2023 “Për vlerësimin dhe analizimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit për Sektorin e Prokurimeve”.

Është specifikuar se duhen analizuar gjetjet 3 - 4 të masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike ku përshihet edhe rekomandimi i sipërcituar Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**4.1. Rekomandimi:** AKSHI të marrë masa dhe të analizojë rastin me qëllim që në të ardhmen, të mos marrë në dorëzim jashtë afateve projekte/produkte, pa përcaktuar dhe kërkuar më parë përlllogaritjen dhe mbajtjen e penalteteve ndaj. Për praktikën, të nxjerrë përgjegjësitë për moskërkimin dhe arkëtimin nga subjekti “H. shpk” të penalteteve për vonesa në dorëzimin në afat të produktit, sipas kontratës.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konkretisht Urdhër nr.484 datë 05.10.2023 “Për vlerësimin dhe analizimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit për Sektorin e Prokurimeve”.

Është specifikuar se duhen analizuar gjetjet 3 - 4 të masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike ku përshihet edhe rekomandimi i sipërcituar Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

## **D. MASA DISIPLINORE**

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Kontratën Kolektive të Punës dhe kontratën individuale të punës, *i rekomandohet* Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, vlerësimi i problematikave dhe shkeljeve të përshkruara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi dhe dhënia e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

## **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Nga auditimi i ushtruar në **Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit**, në zbatim të Programit të Auditimit nr.900/1 prot, datë 11.10.2023. “Për zbatimin e rekomandimeve të

lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, dërguar me shkresën nr.730/16 datë 03.05.2023 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e Përputhshmërisë” rezulton se rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit,

Në kushtet e të qenurit brenda afatit 6 mujor që duhet për kthim përgjigje grupi i auditimit nuk mund të shprehet mbi përmbushjen ose jo të këtij afati, por ngelet për tu vlerësuar gjatë periudhës 6 (gjashtë) mujore, në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve”

Subjekti dhe lloji i masës	Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar			
		Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
<b>AKSHI</b>	<b>33</b>	<b>33</b>	<b>0</b>	<b>17</b>	<b>2</b>	<b>12</b>	<b>2</b>
Masa Organizative	24	24	0	15	0	9	0
Masa Zhdëmtimi	4	4	0	0	2	0	2
Masa Administrative	0	0	0	0	0	0	0
Masa Disiplinore	1	1	0	0	0	1	0
Masa për menaxhimin jo efektiv te fondeve	4	4	0	2	0	2	0
Masa për menaxhimin jo efektiv te fondeve (leke)							

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej **33** rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht ose në masën 100 %, dhe rezultojnë të zbatuara plotësisht **17** rekomandime ose 51,52%.

**Për sa më sipër ri kërkojmë që Agjencia Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara ose zbatuar pjesërisht brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024.**

*Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre.*

### 3.7 DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK

#### PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.900 prot., datë 11.10.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, në ambientet e institucionit, më datë 25.10.2023, u mbajt aktverifikimi nr.6, datë 25.10.2023 nga audituesit e autorizuar të KLSH-së E. K.(përgjegjëse grupi), znj. E. K. anëtare, me znj E.P. në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe znj. D. B. dhe znj. T. T. autorizuar nga titullari për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së.

**Objekt i këtij akt verifikimi është:**

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.1176/8 Prot, datë 30.06.2023 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi Auditimin e Përputhshmërisë” të ushtruar në **Drejtoria të Shërbimit të Trupit Diplomatik**, sipas programit të auditimit nr.1176/1 prot, datë 13.01.2023, për veprimtarinë nga data 01.01.2020 deri në 31.12.2022, në



lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. E.K. (Përgjegjëse Grupi)

2. E.K., anëtar

Auditimi ka filluar më, 11.10.2023

Auditimi ka përfunduar më, 25.10.2023

